



*ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION*

Qendra Trajnuese për Avokatë Programi i trajnimeve 2017

**Ndërtimi dhe zhvillimi i kapaciteteve profesionale për
Avokatët dhe Praktikantët**

Përmbajtja

Hyrje	4
Qëllimi i programit	4
Prioritetet e programit	5
Programi i Arsimimit të vazhdueshëm ligjor të obligueshëm	5
Trajnimet në fushën penale	9
Trajnimet në fushën civile	18
Kushtetuese.....	25
Nërkombëtare.....	26
E drejta Evropiane.....	30
Administrative.....	31
Komerciale.....	32
Etika profesionale e Avokatëve.....	44
Kurse speciale	45
Publikime	46
Përfundim	47

Hyrje

Programi i Punës i Qendrës Trajnuese të Odës së Avokatëve të Kosovës (më tutje OAK), për trajnimin e avokatëve dhe praktikantëve të avokatisë për vitin 2017, shpreh synimet tona drejtë realizimit të arsimit të vazhduar ligjor për avokatë. Për OAK-në viti 2016 ishte periudhë e sfidave dhe mundësive të shumta. Programi i Punës së OAK-së për vitin 2017 është reflektim i nevojave për mbështetje të reformave gjithëpërfshirëse të avokaturës dhe mbështetje në tejkalimin e sfidave për zbatim e Ligjit për Avokatinë dhe legjislacionin tjetër të OAK-së.

Për realizimin e këtij programi të Trajnimit, QTA ka marrë për bazë:

- Pyetësonin për vlerësimin vjetor të nevojave trajnuese i shpërndarë tek të gjithë avokatët.
- Formularët e vlerësimit të trajnimeve të organizuara nga QTA/OAK.
- Takimet me trajnuesit e QTA/OAK.
- Takimet e rregullta me drejtuesit e Zyrave Regjionale të OAK-së.
- Rekomandimet e komiteteve të OAK-së.
- Rekomandimet e takimeve të Bench Bar të Odës së Avokatëve.

Realizimi i objektivave të këtij programi do të bëhet duke u mbështetur në parime të transparencës, mosdiskriminimit, pavarësisë institucionale, profesionalizimit, bashkëpunimit, zbatimit të ligjit si dhe standardeve më të larta të përcaktuara për arsimimin e vazhduar ligjor për avokatët.

Bazuar në funksionet ligjore të OAK-së, janë hartuar programe trajnimi të veçanta të cilat mbështesin këtë program pune. Me këto programe janë përcaktuar aktivitetet konkrete dhe metodologjia e realizimit të tyre.

Nëpërmjet këtij programi pune, do të pasqyrohet në mënyrë të përmbledhur angazhimi i OAK-së për realizimin e programeve të veçanta trajnuese dhe aktiviteteve tjera për vitin 2017.

1. Qëllimet e Programit të Trajnimeve

Disa nga qëllimet kryesore të cilat synohen të arrihen me programin e trajnimit për vitin 2017, janë:

- Ngritja e vazhdueshme profesionale e avokatëve;
- Përgatitja profesionale e praktikantëve të avokatisë;
- Zbatimi i trajnimeve të specializuara për avokatë;
- Zgjerimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë në fushën e trajnimeve;
- Zhvillimi i një metodologjie moderne gjatë zbatimit të programeve trajnuese;
- Pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme për arsimimin ligjor të karakterit ndërkombëtarë.

2. Prioritetet e Programit të Trajnimeve

Realizimi i aktiviteteve trajnuese do të bëhet mbi bazë të prioriteteve të përcaktuara me programin vjetor të punës për vitin 2017, duke pasur parasysh edhe kapacitetet administrative, profesionale dhe financiare të OAK-së.

Renditja e prioriteteve programore, sipas rëndësisë së tyre, bëhet si më poshtë:

- Arsimimi i Vazhdueshëm Ligjor i Obligueshëm për Avokatë;
- Programi Gjithëpërfshirës për Praktikantë;
- Organizimi i Provimit të Etikë për Avokatë/ Provimi hyrës për Avokatë të huaj
- Programi për Trajnimet e Jurisprudencës;
- Hulumtime dhe Publikime.

3. Programi i Arsimimit të Vazhdueshëm Ligjor të Obliguar (AVLO)

Përmbajtja e AVLO për vitin 2017 shpreh nevojat e avokatëve bazuar në pyetësin e trajnimeve për vlerësimin e nevojave të anëtarësisë.

Programi i AVLO-së është hartuar nga stafi i OAK-së, ekspertë të ndryshëm dhe trajnues të OAK-së.

Ai bazohet në nevojat e shprehura nga përfituesit e tij si dhe është përmbledhur duke përdorur teknika dhe metodologji të veçanta të cilat kanë mundur një program gjithëpërfshirës dhe të llojllojshëm.

3.1 Objektivat e AVLO -së

Në përmbushje të nevojave dhe pritjeve për një avokati me integritet të lartë profesional, etike, të paanshme, të pavarur dhe moderne, AVLO ka këto objektiva:

- Arsimim Ligjor për Avokatët lidhur me reformat legislative si dhe zhvillimet në praktikën e Avokatisë;
- Ofrimi i mbështetjes profesionale avokatëve në punën e tyre praktike;
- Nxitja e shkëmbimit të njohurive, metodave dhe praktikave më të mira profesionale;
- Forcimi i shkathtësive profesionale të shkrimit, arsyetimit dhe argumentimit gjatë zbatimit të ligjit në praktikë;
- Dhënia e kontributit për mbajtjen e avokatëve të informuar për zhvillimet në lëmin e jurisprudencës, ekonomik, social dhe kulturor;
- Ngritja e njohurive të avokatëve rreth të drejtës ndërkombëtare në veçanti të së drejtës evropiane;
- Ofrimi i një qasje multidisciplinare për temat apo çështjet e adresuara nga nevojat për trajnim të avokatëve;

3.2. Përmbajtja e AVLO-së

AVLO, për vitin 2016 përmban në vete për trajtim çështje nga:

- E drejta penale (materiale, procedurale dhe ekzekutimi i sanksioneve penale);
- Drejtësia për të mitur;
- E drejta civile (materiale dhe procedurale);
- E drejta tregtare;
- E drejta administrative;
- E drejta e punës;
- E drejta kushtetuese;
- E drejta e BE-së;
- Mbrojtja ndërkombëtare e lirive dhe të drejtave themelore;
- Etika profesionale dhe sistemi disiplinor;
- Kurse të specializuara (përfshirë zhvillimin e shkathtësive të veçanta të avokatëve).

3.3. Burimet për hartimin e AVLO

Me qëllim që AVLO t'u përgjigjet nevojave të avokatëve për trajnim janë përdorur burimet e poshtëshënuara:

- Analiza e formave të vlerësimit të aktiviteteve trajnuese të organizuara në vitin 2014;
- Përgjigjet e pyetësorëve të dërguara avokatëve me qëllim të propozimit të temave për trajnim për vitin 2017;
- Rekomandimet nga Bench Bar – (tryezat e përbashkëta me Avokatë, Gjyqtarë e Prokurorë);
- Takime me anëtarësinë në regjione dhe Kryetarët e Degëve Regjionale;
- Propozimet e grupit të ekspertëve të caktuar për hartim të programeve trajnuese;
- Diskutimet me avokatët;
- Propozimet e trajnuesve të OAK-së të dhëna në takime të veçanta gjatë vitit 2014;
- Propozimet e donatorëve/partnerëve të ndryshëm të cilët mbështesin OAK-në;
- Rekomandimet e raporteve të ndryshme të organizatave vendore dhe ndërkombëtare;
- Konkluzionet e takimeve të Këshillit Drejtues të OAK-së.

3.4. Përfituesit

Përfitues të trajnimeve dhe aktiviteteve të QTA-së, janë:

- Avokatët;
- Praktikantët;
- Profesionistët e tjerë ligjor të përcaktuar nga OAK.

4. TRAJNIMET NË FUSHËN PENALE

Moduli: "KODI I PROCEDURËS PENALE"

4.1 Tema: "SHQYRTIMI FILLESTAR DHE SHQYRTIMI I DYTË "

Hyrje:

Temat që kanë të bëjnë me shqyrtimin fillestar dhe shqyrtimin e dytë sipas Kodit të Procedurës Penale (Kodi nr.04/L-123), janë tema mjaft të rëndësishme dhe njëkohësisht mjaft aktuale duke pasur parasysh faktin se janë faza të rëndësishme të procedurës penale dhe janë faza që për herë të parë janë paraparë me legjislacionin i cili është në fuqi nga 1 janari i vitit 2013.

Dispozitat që rregullojnë këtë fazë të procedurës penale parashohin një rol mjaft aktiv të palëve në procedurë, sidomos të të pandehurit dhe të dëmtuarit të cilët përfaqësohen nga ana e mbrojtësve, andaj arsyeshmëria e trajtimit të kësaj teme ndërlidhet edhe me obligimet e palëve në procedurë e veçanërisht nga këndvështrimi i mbrojtësve përkitazi me avansimin e rolit të tyre gjatë këtyre procedurave posaçërisht në kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hudhjen e aktakuzës.

Objektivat e trajnimit

Pjesëmarrësit e këtij trajnimi në përfundim të tij duhet ti arrijnë këto objektiva:

- të interpretojnë drejtë dispozitat që kanë të bëjnë me shqyrtimin fillestar dhe shqyrtimin e dytë;
- të identifikojnë nga këndvështrimi i mbrojtësve të drejtat dhe detyrimet e palëve që përfaqësojnë gjatë fazës së shqyrtimit fillestar dhe shqyrtimit të dytë;
 - të diskutojnë problemet dhe vështirësitë praktike me rastin e zbatimit të shqyrtimit fillestar, shqyrtimit të dytë dhe të shqyrtimit gjyqësor.
 - Temat që do të trajtohen janë:
 - kundërshtimi i provave dhe kërkesa për hudhjen e aktakuzës nga ana e të pandehurve;
 - përgjigjet në pretendimet e palëve përkitazi me kërkesat gjatë shqyrtimit të dytë apo në mes fazën mes shqyrtimit fillestar dhe shqyrtimit të dytë me vështrim të posaçëm nga këndvështrimi i mbrojtësve;
 - paraqitja e materialeve nga mbrojtja në shqyrtimin e dytë.

Kohëzgjatja e trajnimit: Njëditor

Përfituesit: Avokatët dhe avokatët praktikant

Trajnues:

4.2 Tema: “MASAT PËR SIGURIMIN E PRANISË SË TË PANDEHURIT ”

Hyrje:

Temat që kanë të bëjnë me masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit për zhvillimin e procedurës penale janë mjaft të rëndësishme dhe të cilat masa janë të parapara me Kodin e Procedurës Penale (Kodi nr.04/L-123).

Këto masa janë mjaft të rëndësishme të trajtohen duke u bazuar në faktin se aplikohen në të gjitha fazat e procedurës penale që nga faza e hetimit e deri në fazën përfundimtare të procedurës penale.

Dispozitat që rregullojnë këto masa janë të shumëllojshme dhe po ashtu edhe kushtet për aplikimin e tyre janë specifike për secilën masë të aplikuar, ashtu që edhe avokatët mbrojtës duhet të kenë rol mjaft të rëndësishëm në ofrimin e alternativave përkatësisht të kërkojnë aplikimin e masave më të buta karshi masave më të ashpra që aplikohen nga ana e gjykatësve e posaçërisht në shmangien e aplikimit të masës më të rëndë të paraburgimit e cila është përcjellë me shumë kritika se është aplikuar shpesh.

Objektivat e trajnimit

Pjesëmarrësit e këtij trajnimi në përfundim të tij duhet ti arrijnë këto objektiva:

- të interpretojnë drejtë dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit;
- Që nga këndvështrimi i mbrojtësve të argumentojnë aplikimin e masave më të buta për të pandehurit
- Të diskutojnë problemet dhe vështirësitë praktike me rastin e caktimit të masave të pranisë së të pandehurit.

Temat që do të trajtohen janë:

- thirrja, urdhërarresti, premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin;
- -ndalimi për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar, paraqitja në stacionin policor, dorëzania, diversioni
- arresti shtëpiak dhe paraburgimi.

Kohëzgjatja e trajnimit: Njëditor

Përfituesit: Avokatët dhe avokatët praktikant

Trajnues:

4.3 Tema: MARRJA NË PYETJE GJATË HETIMIT

Hyrje

Avokatët si të autorizuar të palëve në procedurë, sidomos nga të pandehurit kanë një pozicion mjaft specifik në procesin e hetimeve. Duke marrë për bazë llojet e marrjes në pyetje dhe personat që merren në pyetje gjatë hetimeve, është e nevojshme që të bëhet dallimi në mes të marrjes në pyetje, marrjes së deklaratës dhe mundësisë hetuese të veçantë. Gjithashtu duhet dalluar situatat dhe rastet kur merren në pyetje apo u merren deklaratat e dëshmitarëve të rëndomtë, të privilegjuar, bashkëpunues, të mbrojtur si dhe të pandehurve. Në këtë drejtim vlen të trajtohet edhe çështja e mundësisë hetuese të veçantë.

Objektivat e trajnimit

- Të bëhet dallimi në mes të marrjes në pyetje dhe marrjes së deklaratës,
- Të identifikohen rastet kur mund të bëhet hetimi i veçantë;
- Të bëhet dallimi në mes procesverbaleve për marrjen në pyetje apo të deklaratave sipas llojit të dëshmitarëve dhe të pandehurve.

Temat që do të trajtohen janë:

- Marrja në pyetje dhe marrja e deklaratës;
- Mundësia hetuese e veçantë
- Llojet e procesverbaleve sipas personave që merren në pyetje apo që japin deklaratë

Kohëzgjatja e trajnimit: Njëditor

Përfituesit: Avokatët dhe avokatët praktikant

Trajnues:

4.4 Tema : “DËNIMET ALTERNATIVE SIPAS DISPOZITAVE TË KODIT PENAL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS”

Hyrje:

Dënimet alternative janë dënime që janë paraparë në kuadër të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe janë tri lloje të këtyre dënimeve dhe atë dënimi me kusht, gjysmëliria dhe urdhri për punë në dobi të përgjithshme, kurse është e rëndësishme se së bashku me dënimin me kusht mund të shqiptohen edhe urdhri për trajtim të detyrueshëm rehabilitues dhe urdhri për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues.

Dënimet alternative dispozitat që rregullojnë këto masa janë të shumëllojshme dhe po ashtu edhe kushtet për aplikimin e tyre janë specifike për secilën masë të aplikuar, ashtu që edhe avokatët mbrojtës duhet të kenë rol mjaft të rëndësishëm në ofrimin e alternativave përkatësisht të kërkojnë aplikimin e masave më të buta karshi masave më të ashpra që aplikohen nga ana e gjykatësve e posaçërisht në shmangien e aplikimit të masës më të rëndë të paraburgimit e cila është përcjellë me shumë kritika se është aplikuar shpesh.

Objektivat e trajnimit

Pjesëmarrësit e këtij trajnimi në përfundim të tij duhet ti arrijnë këto objektiva:

- të përkufizojnë llojet e dënimeve alternative;
- që nga këndvështrimi i mbrojtësve të argumentojnë aplikimin e këtyre dënimeve në rastet kur plotësohen kushtet ligjore;
- Të diskutojnë problemet dhe vështirësitë praktike me rastin e zbatimit të detyrimeve që shqiptohen së bashku me dënimin me kusht.

Temat që do të trajtohen janë:

- dënimin me kusht, qëllimi, kushtet dhe revokimi i dënimin me kusht;
- Dënimi me urdhër për punë në dobi të përgjithshme;
- Gjysmëliria.

Kohëzgjatja e trajnimit: Njëditor

Përfituesit: Avokatët dhe avokatët praktikant

Trajnues:

4.5 Tema: Drejtësia për të mitur

Kodi i Drejtësisë për të Mitur përcakton procedura të veçanta për të miturit si kryes të veprave penale dhe prezanton koncepte dhe institute të reja në legjislacionin dhe administrimin e drejtësisë për të mitur në Kosovë. Gjithashtu te miturit duhet të trajtohen në mënyrë të veçantë edhe kur janë të dëmtuar apo dëshmitarë në procedurë. Për këtë arsye është e nevojshme hartimi i një moduli i cili do të përmbajë trajnime adekuate për avokatë dhe praktikantë.

Ky modul do të dizajnohet në atë mënyrë që të përfshijë temat si më poshtë:

- Procedura përgatitore dhe shqyrtimi gjyqësor;
- Masat dhe dënimet e zbatueshme ndaj të miturve;
- Viktimat dhe dëshmitarë të mitur;

Të gjitha temat e lartshënuara do të trajtohen me fokus në standardet dhe instrumentet ndërkombëtare të drejtësisë për të mitur.

Objektivat e trajnimit

Pas përfundimit të trajnimeve të përcaktuara në këtë modul, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Përfaqësojnë në mënyrë efektive profesionale dhe etike interesat e të miturit në procedurat e zhvilluara ndaj tij;
- Të bëjnë propozimet e duhura përmes parashtrësive adekuate bazuar në ligj, gjendjen faktike dhe provat materiale;
- Të mbrojnë në mënyrë efektive interesat e të miturve si të dyshuar, viktimat

apo dëshmitarë.

Kohëzgjatja e trajnimit: Tre ditore

Përfituesit: Avokatët dhe praktikantët avokatë

Trajnues:

4.6 Tema: Mbrojtja efektive në trajtimin e rasteve të krimit të organizuar

Është i njohur fakti se ndër çështjet sfiduese për avokatët mbetet qasja e tyre në ofrimin e mbrojtjes efektive dhe përfaqësimin e rasteve në të cilat shprehen elementet e krimit të organizuar. Në këtë drejtim do të organizohen trajnime të cilat do të përqendrohen në: definimin e elementeve të krimit të organizuar dhe pjesëmarrjen ose organizimin e grupit kriminal. Këto çështje do të trajtohen lidhur me veprat penale si në vijim:

- Trafikimi me qenie njerëzore dhe kontrabandimi me migrantë;
- Trafikimi me substanca narkotike;
- Terrorizmi.

Objektivat e trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Përfaqësojnë në mënyrë efektive interesat e të pandehurve në procedurat lidhur me trafikimin me njerëz, kontrabandimin me migrantë, trafikimin me substanca narkotike dhe terrorizmin;
- Sfidojnë pretendimet e prokurorisë në raport me cilësimin juridik të veprave penale me të cilat ngarkohen të mbrojturit;
- Kundërshtojnë provat e papranueshme në procedura penale lidhur me këto vepra penale.

Kohëzgjatja e trajnimit: Një ditore

Përfituesit: Avokatët dhe praktikantët avokatë

4.7 Tema: Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare

Korrupsioni si dukuri negative është pengesë në zhvillimin e përgjithshëm të vendit. Lufta kundër korrupsionit konsiderohet si prioritet për krijimin e shtetit ligjor. Lufta efikase kundër korrupsionit shtron nevojën e analizimit të sfidave nga ana e avokatëve në mënyrë që të ngritet profesionalizmi i tyre në mbrojtje efektive profesionale dhe etike të klientëve në procedura ligjore lidhur me këto vepra penale.

Trajnimi i organizuar lidhur me këtë temë do të përfshijë çështjet si në vijim:

- Zbatimi i kornizës ligjore kundër korrupsionit;
- Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar;
- Marrja dhe dhënia e ryshfetit (përfshirë zyrtarin e huaj publik);
- Konflikti i interesit;
- Ushtrimi i ndikimit.

Objektivat e trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Të interpretojnë dhe propozojnë zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore lidhur me korrupsionin;
- Të sfidojnë cilësimet juridike të veprave penale me elemente të korrupsionit;
- Të kundërshtojnë bazat e akuzave sipas pretendimeve të palës paditëse vendimet me shkelje procedurale dhe materiale.

Kohëzgjatja e trajnimit: Një ditë

Përfituesit: Avokatët dhe praktikantët avokatë

Trajnues:

4.6 Tema: Krimet e luftës

Zhvillimet aktuale lidhur me themelimin e gjykatës speciale për krime të luftës, nevoja për të ofruar mbrojtje efektive, profesionale dhe etike nga ana e avokatëve vendor si dhe në ekipe mbrojtëse me avokat të huaj, shtron nevojën e ngritjes së kapaciteteve në këtë drejtim. Për këtë qëllim do të organizohen trajnime adekuate të cilat ndihmojnë ngritjen e shkathtësive praktike të avokatëve në mënyrë që ata të mbrojnë interesat e klientëve të tyre dhe aplikojnë parimet e drejtësisë.

Në kuadër të këtij trajnimi do të trajtohen:

- Menaxhimi i rasteve nga ekipi mbrojtës;
- Sigurimi i provave në interes të mbrojtjes;
- Zbatimi i të drejtës vendore dhe ndërkombëtare lidhur me të drejtën humanitare në raste të konflikteve të armatosura.

Objektivat e trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbatojnë metodologji më të avancuara dhe praktike të menaxhimit të rasteve në ekip;
- Sigurojnë dhe prezantojnë provat të cilat mbështesin teorinë e rastit të tyre;
- Zbatojnë normativën vendore dhe standardet ndërkombëtare lidhur me të

drejtën humanitare.

Kohëzgjatja e trajnimit: Një ditë

Përfituesit: Avokatët dhe praktikantët avokatë

Trajnues:

4.7 Tema: Masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit

Duke marrë për bazë faktin se në praktikë janë evidentuar vështirësi që kanë të bëjnë me urdhërimin dhe zbatimin e masave të fshehta dhe teknike të hetimit dhe vëzhgimit, përmes këtij trajnimi synohet që këto vështirësi të tejkalohen, duke i trajtuar çështjet më sfiduese që ndërlidhen me zbatimin e tyre. Në anën tjetër, këto masa kanë ndikim të madh në një proces penal, andaj shtrohet nevoja e trajtimit në një tryezë profesionale me pjesëmarrje të avokatëve dhe praktikantët e avokatisë.

Çështjet të cilat do të diskutohen në kuadër të këtij trajnimi janë:

- Veprat penale për të cilat lëshohen masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit;
- Procedura e urdhërimit dhe zbatimit të masave të fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit;
- Sfidimi i pranueshmerisë së provave të nxjerra përmes masave të fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit.

Objektivat e trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Kërkojnë zbatimin e drejtë të dispozitave që kanë të bëjnë me këto masa;
- Kuptojnë procedurën dhe kushtet për lëshimin e masave të fshehta;
- Të kundërshtojnë provat e nxjerra me shkelje ligjore lidhur me masat e fshehta.

Kohëzgjatja e trajnimit: Një ditë

Përfituesit: Avokatët dhe praktikantët avokatë

Trajnues:

4.8 Tema: Krimi Kibernetik

Hyrje:

Njerëzimi tani më është i varur nga teknologjitë e informacionit dhe komunikimit, kështu që numri i krimeve me element të krimit kibernetik është duke u rritur,

kriminelet nuk e kufizojnë veten brenda kufijve të një shteti, prandaj rritet nevoja që avokatët të jenë të përgatitur, që ti trajtojnë këto çështje duke kuptuar natyrën e këtyre krimeve, kërcënimet, tendencat dhe sfidat e krimit kibernetik dhe gjithashtu të kenë njohuri për legjislacionin vendor ashtu edhe atë ndërkombëtar si dhe procedura e cila ndiqet për trajtimin e këtyre çështjeve.

Objektivat e trajnimit

Ne fund të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të fitojnë njohuri për:

- Krimin Kibernetik dhe Provat Elektronike
- Cilat ligje materiale apo procedurale si dhe cilat teknologji mund të zbatohen
- Konceptet e krimit kibernetik lidhur me veprat penale sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar,
- Ndikimet që teknologjia e ka në krim
- Funksionimi i internetit dhe impakti në krim

Me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve të përfaqësimit në rastet e krimeve kibernetike ky trajnim do të trajtojë këto tema:

- Hyrje në kërcënimet, tendencat dhe sfidat e krimit kibernetik;
- Krimi kibernetik si vepër penale në legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar;
- Provat elektronike-procedura dhe praktika;
- Teknologjia;
- Interneti.

Kohëzgjatja e trajnimit: Një ditë

Përfituesit: Avokatët dhe praktikantët e avokatisë

Trajnues:

4.9 Tema : Konfiskimi i aseteve dhe pasurisë së fituar me vepër penale

Hyrje:

Dëmtimi i vlerave të ndryshme me veprimet kriminale në shumicën e rasteve kanë për pasojë përfitime të ndryshme pasurore. Në shume raste ky është ndër motivet kryesore të kryesit të veprës penale. Kodi Penal e parasheh edhe konfiskimin e detyrueshëm, ndërsa Kodi i Procedurës penale përcakton detyrimin e prokurorit që të shqyrtojë konfiskimin në disa faza. Për më tepër parashihen mjete dhe kompetenca të zgjeruar për hetuesin dhe prokurorin në identifikimin e pasurisë dhe konfiskimin e tyre. Zhvillimi i kapaciteteve të avokateve në njohjen dhe interpretimin e drejtë të këtyre dispozitave shtrojnë nevojën e trajtimit të kësaj teme.

Objektivat e trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Të kuptojnë sekuestrimin e përkohshëm dhe procedurë për sekuestrim
- Të kuptojnë konfiskimin e përhershëm;
- Të analizojnë procedurën për identifikimin e pasurisë;
- Të identifikojnë rastet e ngrirjes dhe ndalimit të pasurisë;
- Të kuptojnë drejtë procedurën e konfiskimit pas ngritjes së aktakuzës

Struktura e re ligjore themelon institucione dhe mekanizma adekuat të cilët merren me konfiskimin e aseteve dhe pasurisë së fituar me vepër penale. Në këtë frymë trajnimi i avokatëve do të ketë në përmbajtje këto çështje:

- Sekuestrimi i përkohshëm,
- Konfiskimi i sendeve përkohësisht të sekuestruara,
- Pasuria që i nënshtrohen automatikisht konfiskimit
- Kthimi i sendeve të sekuestruara,
- Ngrirja e aseteve dhe urdhrat ndalues
- Masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë
- Të drejtat e personave të tretë që posedojnë dobi pasurore nga veprat penale.

Kohëzgjatja e trajnimit: Një ditë

Përfituesit: Avokatët dhe praktikantët e avokatisë

Trajnues:

4.11 Negocimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë

Hyrje:

Marrëveshja për pranimin e fajësisë është vullnet i dyanshëm i të akuzuarit mbrojtësit të tij në një anë dhe prokurorit në anën tjetër, me arritjen e se cilës i akuzuari përfiton benificione të ndryshme. Në fokus të këtij trajnimi do të jetë avancimi i njohurive lidhur me subjektet sidomos të avokatëve dhe kushteve për negocimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, kushtet ligjore për lidhjen e marrëveshjes, procedura për lidhjen e marrëveshjes dhe vendosja nga ana e gjykatës për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

Objektivat e trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Të identifikojnë kushtet për negocimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë;
- Të njohin procedurat për lidhjen e marrëveshjes;
- T'i zbatojnë procedurat përkitazi lidhur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë.
- Të kuptojnë rolin e mbrojtësit ne procedurën e negocimit te marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Temat:

- Propozimi dhe procedura e negocimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë;
- Roli i mbrojtësit-avokatit ne negocimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë,
- Roli i subjekteve të procedurës penale me rastin e negocimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë;
- Dallimi në mes marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe pranimin të fajësisë.

Kohëzgjatja e trajnimit: Një ditë

Përfituesit: Avokatët dhe praktikantët e avokatisë

Trajnues:

4.12 Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar (penale - civile)

Për shkak të krijimit të komunikimit të rregullt në fushën e ndihmës juridike ndërkombëtare dhe për shkak të ndjeshmërisë së kësaj çështje, është paraqitur nevoja e organizimit të një trajnimi lidhur me këtë temë. Në këtë trajnim do të trajtohen këto çështje:

- Njohja dhe zbatimi i vendimeve të huaja;
- Sigurimi i provave;
- Ekstradimi;
- Transferimi i personave të gjykuar;
- Raste nga praktika

Kohëzgjatja e trajnimit: Një ditë

Përfituesit: Avokatë

Trajnues:

5 TRAJNIMET NË FUSHËN CIVILE

Moduli : Civile materiale

5.1 Tema : PRONËSIA - autorizimet dhe kufizimet e pronarit të sendit

Hyrje:

Pronësia është një prej instituteve më të rëndësishme të së drejtës civile në përgjithësi dhe i të drejtës sendore në veçanti. Pronësia si e drejtë absolute gëzon mbrojtje me aktet më të larta juridike, me ligj, dhe me instrumente ndërkombëtare. Është në interes të përgjithshëm të trajtohet kjo temë në këtë kohë kur ka ndryshime në legjislacion dhe probleme të trashëguara rreth pronësisë.

Prandaj do të jenë pjesë e trajnimit këto tema:

- Autorizimet e pronarit të sendit të paluajtshëm,
- Kufizimet e pronarit të sendit,
- Padit për mbrojtje gjyqësore të së drejtës së pronësisë,

Objektivat e Trajnimit

Objektivi i këtij trajnimi është që pjesëmarrësit pas përfundimit të këtij trajnimi të jenë në gjendje:

- Të shpjegojnë përkufizimet e në mes të pronësisë dhe drejtës së pronësisë,
- Të bëjnë dallimet në mes të pronësisë dhe pasurisë,
- Të kuptojnë karakteristikat e të drejtës së pronësisë,
- Të marrin njohuri lidhur me institutet me të cilat kufizohet e drejta e pronësisë,
- Të marrin njoftime lidhur me nenin 1 të Protokolit 1 të KEDNJ.

Kohëzgjatja e trajnimit: një ditë

Përfituesit: Avokatët

Trajnues:

5.2 Tema: PADITË PËR MBROJTJEN E TË DREJTËS SË PRONËSISË

Hyrje

Për cenimin e të drejtës së pronësisë si e drejtë subjektive të karakterit absolut ofrohet mbrojtja gjyqësore në të gjitha sistemet juridike. Pronësia me ligjet pozitive si dhe me Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (KEDNJ) dhe Protokolli 1 i garantohet e drejta e pronësisë dhe mbrojtja

pronarit të sendit. Sistemet e mbrojtjes së pronësisë si dhe padit dhe llojet padive paraqiten që nga e drejta romake. Paditë tradicionale për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë janë padia e reivindikimit, padia publiciane dhe padia negatore.

Prandaj do të jenë pjesë e trajnimit këto tema:

- Mbrojtja e të drejtës së pronësisë,
- Llojet e padive,
- Padia rei vindikimit,
- Padia publiciane,
- Padia negatore.

Objektivat mësimore

Objektivi i këtij trajnimi është që pjesëmarrësit pas përfundimit të këtij trajnimi do të jenë në gjendje që :

- Të kuptojnë rendësin e mbrojtjes së pronësisë,
- Të shpjegojnë llojet e padive për mbrojtjen e pronësisë,
- Të bëjnë dallime në mes këtyre padive,
- Të kuptojnë rendësin e nenit 1 të Protokolit 1 të Konventës Evropiane mbi mbrojtjen e drejtave dhe lirive themelore të e njeriut,
- Të shpjegojnë rendësin e këtyre padive për mbrojtjen e pronësisë,
- Të dinë të aplikojnë ligjet për këto padi,
- Raste nga praktika.

Kohëzgjatja e trajnimit: një ditë

Përfituesit: Avokatët

Trajnues:

5.3 Tema: Shpronësimi dhe procedura e shpronësimit si dhe kompensimi

Hyrje:

Siç dihet instituti juridik i eksproprijimit, e që tani quhet shpronësim, deri në vitin 2009, ka qenë juridikisht i rregulluar me ligjin për eksproprijimin (Gazeta Zyrtare e Kosovës nr. 21/1978) me të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e saj, ndërsa pas shpalljes së pavarësisë, Republika e Kosovës nxori Ligj tjetër me të cilin ka rregulluar juridikisht këtë institut juridik i cili tani është emërtuar si Ligji për shpronësimin e pronës së paluajtshme i shpallur në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 52, datë 8 maj 2009. Pronari mund të zhvishet nga e drejta e pronësisë

vetëm nën kushtet e parapara me ligj me kusht që shpronësimi të bëhet për qëllim të interesit të përgjithshëm.

Prandaj do të jenë pjesë e trajnimit këto tema:

- Organi kompetent për shpronësim,
- Procedura e cila duhet paraprirë shpronësimit,
- Procedura e vlerësimit të pasurisë e cila është objekt i shpronësimit dhe caktimi i kompensimit,
- Raste nga praktika.

Objektivat e trajnimit

Objektivi i këtij trajnimi është që pjesëmarrësit pas përfundimit të këtij trajnimi të jenë në gjendje të:

- analizojnë procedurat e shpronësimit,
- analizojnë dhe identifikojnë kushtet paraprake për shpronësim,
- dallojnë rastet kur organ shpronësues mund të jetë komuna e kur organ shpronësues mund të paraqitet qeveria dhe
- njohin mënyrën e inicimit dhe përfundimit të procedurës së shpronësimit.
- kuptojnë procedurën caktimit të kompensimit,
- vlerësojnë se çka përfshinë kompensimi,
- raste nga praktika.

Kohëzgjatja: Një ditore

Përfituesit: Avokatët

Trajnues:

5.4 Tema: SHPËRBLIMI I DËMIT MATERIAL DHE JO MATERIAL

Numri i madh i kontesteve gjyqësore për shpërblimin e dëmit, qoftë të dëmit material apo jo material, praktika gjyqësore jo e harmonizuar sa i përket vendosjes dhe kriterëve për përcaktimin e lartësisë së dëmit jo material, janë indikator që tregojnë se kjo temë është shumë me rëndësi të trajtohet me avokatë.

Temat që do të përmbaj ky trajnim janë:

- Format e dëmit material dhe jo material,
- Lartësia e kërkesës për dëm,
- Marrëveshjet jashtëgjyqësore për shpërblimin e dëmit,
- Lartësia e kamatës dhe llogaritja e saj,
- Raste nga praktika.

Objektivat e trajnimit

Objektivi i këtij trajnimi është që pjesëmarrësit pas përfundimit të këtij trajnimi të jenë në gjendje të:

- dallojnë format e dëmit,
- kuptojnë kriteret për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit,
- llogarisin kumatën për dëmin jo material.

Kohëzgjatja e trajnimit: Një ditë

Përfituesit: Avokatët

Trajnues:

5.5 Tema: Zgjidhja e martesës dhe pasojat e saj

Hyrje:

Zgjidhja e martesës sjellë pasojat e saja si për bashkëshortët ashtu edhe për fëmijët e tyre të përbashkët. Vendimi mbi zgjidhjen e martesës përmban në vete çështjen e zgjidhjes së martesës, besimit të fëmijëve të përbashkët të bashkëshortëve, kontaktet personale të fëmijëve të mitur me njërin prind si dhe çështja e kontributit për mbajtjen e fëmijëve si edhe bashkëshortit të pasiguruar. Me zgjidhjen e martesës lind çështja e përcaktimit të kontributit në fitimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve si dhe çështja e trashëgimisë së njërit bashkëshort ndaj bashkëshortit tjetër.

Temë shqyrtimi do të jenë:

- Shkaqet për zgjidhjen e martesës,
- Pasojat që kanë të bëjnë me fëmijët
- Pasojat që kanë të bëjnë me bashkëshortët
- Besimi i fëmijëve të përbashkët të bashkëshortëve dhe caktimi i kontakteve
- Raste nga praktika.

Objektivat e trajnimit

Objektivi i këtij trajnimi është që pjesëmarrësit pas përfundimit të këtij trajnimi të jenë në gjendje të:

- identifikojnë shkaqet për zgjidhjen e martesës,
- kuptojnë cilat janë pasojat pas zgjidhjes së martesës,
- vlerësojnë faktet me rastin e vendosjes lidhur me besimin e fëmijëve,
- kenë njohuri lidhur me caktimin e lartësisë së kontributit për mbajtje.

Kohëzgjatja e trajnimit: një ditë

Përfituesit: Avokatët

Trajnues:

5.6 Tema: VËRTETIMI DHE KUNDËRSHTIMI I ATËSISË OSE AMËSISË

Hyrje:

Është temë e ndjeshme meqenëse përfaqëson një rëndësi të drejtat themelore në raportin prindër - fëmijë dhe anasjelltas. Në gjykatat e Kosovës mbetën pa u zgjidhur shumica e lëndëve të kësaj natyre, për shkak të mungesës të institucioneve që bëjnë ekspertiza lidhur me analizat e nën grupeve të gjakut si dhe ADN-së. Me qëllim që avokatët të jenë sa më të suksesshëm në këto konteste është e nevojshme të marrin informata lidhur me çështje procedurale në këto konteste dhe llojet e ekspertizës që duhet të kryhen për çfarë temë e shqyrtimit do të jenë:

- Procedura gjyqësore në kontestet rreth vërtetimit dhe kundërshtimit të atësisë ose amësisë,
- Kundërshtimi i atësisë ose amësisë nga personi i tretë,
- Administrimi i provave me rastin e vërtetimit si dhe mohimit të atësisë ose amësisë,
- Raste nga praktika.

Objektivat e trajnimit

Objektivi i këtij trajnimi është që pjesëmarrësit pas përfundimit të këtij trajnimi të jenë në gjendje të:

- identifikojnë afatet ligjore për ushtrimin e padisë për vërtetim ose mohim të atësisë dhe amësisë,
- kuptojnë se cilat prova duhet propozuar për tu administruar,
- raste nga praktika.

Kohëzgjatja e trajnimit: Njëditor

Përfituesit: Avokatët

Trajnues:

5.7 Tema: Pjesa e domosdoshme e trashëgimisë

Hyrje:

E drejta e disponimit është e drejtë e çdo personi dhe ajo në shumicën e rasteve nuk paraqet kufizime. Personi mund të disponoj me pasurinë e tij gjatë jetës si edhe në rast vdekjes. Disponimi i pasurisë është i kufizuar me pjesën e domosdoshme. Pjesa e domosdoshme e trashëgimisë i takon vetëm trashëgimtarëve të domosdoshëm të trashëgimisë në pjesën që u takon sipas ligjit.

Temë e shqyrtimit në këtë trajnim do të jetë:

- pjesa e domosdoshme e trashëgimisë,
- trashëgimtarët e domosdoshëm,
- llogaritja e pjesës së domosdoshme të trashëgimisë,

Objektivat mësimore

Objektivi i këtij trajnimi është që pjesëmarrësit pas përfundimit të këtij trajnimi të jenë në gjendje të:

- identifikojnë se cilët janë trashëgimtarët e domosdoshëm,
- kuptojnë llogaritjen e pjesës së domosdoshme të trashëgimisë,
- përcaktojnë pjesën e domosdoshme të trashëgimisë të trashëgimtarëve të rendit të parë dhe rendit të dytë,
- Raste nga praktika.

Kohëzgjatja e trajnimit: Njëditor

Përfituesit: Avokatët

Trajnues:

5.8 Tema: Procedura e shpalljes së personit të zhdukur për të vdekur dhe të provuarit e vdekjes

Avokatët gjatë përfaqësimit të palëve me që kanë interes në këtë procedurë, hasin në vështirësi në praktiken e kësaj procedure, nuk bëhen dallime mbi shpalljen e zhdukjes së një personi nga shpallja e vdekjes së një personi, veprimet e gjykatës si dhe kushtet ligjore për shpalljen e zhdukjes së një personi.

Prandaj temë e këtij trajnimi do të jenë këto tema:

- Kompetenca për zhvillimin e procedurës,
- Forma e vendimeve
- Shpallja e zhdukjes së një personi si të vdekur,
- Shpallja e vdekjes së një personi,
- Raste nga praktika.

Objektivat e trajnimit

Objektivi i këtij trajnimi është që pjesëmarrësit pas përfundimit të këtij trajnimi të jenë në gjendje të:

- kuptojnë kushtet për shpalljen e një personi të zhdukur për të vdekur,
- kuptojnë për shpalljen e vdekjes së një personi,
- kenë njohuri për procedurat në këto çështje si dhe kompetencat,

- raste nga praktika.

Kohëzgjatja: Një ditë

Përfituesit: Avokatët

Trajnues:

MODULI: PROCEDURA CIVILE

5.9 Tema: SIGURIMI I KËRKESËPADISË

Për shkak se procedura për nxjerrjen e vendimit në një çështje juridiko kontestuese mund të zgjatet ashtu që paditësi i cili ka inicuar procedurën nuk mund të realizoj kërkesën e tij gjerë në marrjen e vendimit të formës së prerë nga ana e gjykatës. Ligji i jep mundësi që për hirë të sigurisë së paditësit që në çdo fazë të procedurës e në kushtet e përcaktuara me ligj të propozoj masat e sigurimit të kërkesëpadisë me të cilat sigurohet paditësi në realizimin e kërkesës së tij. Për aprovimin e masave të sigurisë të propozuara nga ana e paditësit duhet të plotësohen kushtet ligjore.

Prandaj temë e shqyrtimit në këtë trajnim do të jetë:

- kuptimi i masave të sigurimit të kërkesëpadisë;
- llojet e masave për sigurimin e kërkesëpadisë;
- kushtet për lejimin e masës së sigurimit të kërkesëpadisë;
- garancioni.

Objektivat e trajnimit

Objektivi i këtij trajnimi është që pjesëmarrësit pas përfundimit të këtij trajnimi të jenë në gjendje të:

- të kuptojnë masat e sigurimit të kërkesëpadisë,
- të dallojnë masën e sigurimit të kërkesëpadisë dhe masën e përkohshme,
- të njohin procedurat dhe kushtet për lejimin e masës së sigurimit të kërkesëpadisë,
- të kuptojnë rëndësinë dhe kushtet e garancionit.

Kohëzgjatja e trajnimit: Një ditë

Përfituesit: Avokatët.

Trajnues:

5.10 Tema: MJETET E REGULLTA DHE MJETET E JASHTËZAKONSHME TË GODITJES SË VENDIMEVE

Hyrje:

Në këtë modul do të bëhet fjalë për ankesën kundër aktgjykimit si mjet të rregullt juridik, procedurën rreth ankesës dhe vendimet të cilat merren nga ana e gjykatës instancionale më të lartë si dhe për mjetet e jashtëzakonshme të goditjes së vendimeve gjyqësore.

Prandaj temë e shqyrtimit në këtë trajnim do të jetë:

- Veprimi i gjykatës së shkallës së parë sipas mjeteve të goditjes së vendimeve gjyqësore,
- Veprimi i gjykatës së shkallës së dytë sipas mjeteve të rregullta juridike,
- Veprimi i gjykatës së shkallës së parë sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike,
- Veprimi i gjykatës së revizionit sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike.

Objektivat e trajnimit

Pas përfundimit të këtij prezantimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Të bëjnë vlerësimin e aktgjykimit dhe mundësisë së ankesës kundër tij,
- Të përpilojnë ankesë kundër aktgjykimit,
- Të përpilojnë ankesë kundër aktvendimit,
- Të dinë se në çfarë afati mund ta kryejnë këtë veprim procedural,
- Të dinë përmbajtjen e ankesës dhe shkaqet për shkak të të cilave mund të ushtrohet një ankesë,
- Të dallojnë shkeljet thelbësore të procedurës kontestimore nga gjendja faktike dhe aplikimi i gabuar i të drejtës materiale,
- Të njohin procedurën sipas mjeteve të zakonshme dhe
- Të dinë vendimet e gjykatës instancionale më të lartë.
- Të vlerësojnë drejtë mundësin e ushtrimit të mjetit të jashtëzakonshëm,
- Të përpilojnë revizionin kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë;
- Të përpilojnë revizionin kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë;
- Të dinë se në çfarë afati mund ti kryejnë këto veprime procedurale,
- Të dinë të ushtrojnë kërkesën për përsëritjen e procedurës dhe
- Të përpiloj propozimin për ushtrimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Kohëzgjatja: Një ditore

Përfituesit: Avokatët

Trajnues:

6 TRAJNIME NË FUSHËN KUSHTETUESE

Moduli:KUSHTETUES ADMINISTRATIV

6.1 Tema: KËRKESA INDIVIDUALE KUSHTETUESE

Hyrje:

Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me

Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik. Individidi mund ta referoj kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj. Në praktikë numri i ankesave individuale kushtetuese është shumë i lartë, me mbi 90% të rasteve të referuara. Por, fatkeqësisht vetëm një numër shumë i vogël i rasteve deklarohen të pranuar në procedurë kushtetuese. Kjo shtron nevojën për ngritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e përfaqësimit kushtetues për të ndërtuar një sistem më efektiv të mbrojtjes kushtetuese të lirive dhe të drejtave të njeriut.

Objektivat e Trajnimit

- Fitimi i njohurive teorike dhe praktike për kërkesën individuale kushtetuese;
- Identifikimi i kushteve kushtetuese dhe ligjore për referimin individual kushtetues;
- Njohja me të drejtat e aplikantit në procedurën e referimit kushtetues;
- Familjarizimi me përvojën jurisprudenciale të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Ky trajnim do të analizoj por nuk do të kufizohet në trajtimin e këtyre çështjeve:

- Juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës;
- Procedura dhe parimet e procesit kushtetues;
- Inicimi i procedurës së referimit kushtetues ;
- Kriteret formale dhe substanciale për referimin individual kushtetues;
- Subjektet e referimit;
- Shterimi i mjeteve juridike;
- Cenimi i drejtpërdrejtë dhe konkret;
- Afati kohor për referimin kushtetues ;
- Kërkesa për masa të përkohshme;
- Shpenzimet e procedurës;
- Efektet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese

Kohëzgjatja: Një ditë

Përfituesit: Avokatët dhe avokatët praktikantë

Trajnues:

6.2 Tema: TË DREJTAT E NJERIUT DHE REFERIMI NË GJYKATËN EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Hyrje

Të drejtat e njeriut në Kosovë janë të garantuara me Kushtetutë si dhe me aktet kryesore ndërkombëtare të cilat, sipas nenit 22 të Kushtetutës zbatohen në mënyrë direkte në Kosovë. Mbrojtja institucionale dhe adekuate e të drejtave të përcaktuara paraqet elementin themelor në realizimin e këtyre të drejtave. Ekzistojnë mekanizma efikas vendor dhe ndërkombëtar të cilët janë të angazhuar në këtë drejtim.

Objektivat e Trajnimit

- Avancimi i njohurive të pjesëmarrësve në interpretimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen institucionale të tyre.
- Identifikimi i institucioneve dhe procedurave gjyqësore të cilat duhet të ndiqen për realizimin e të drejtave të njeriut. Formulimi dhe dorëzimi i kërkesës/padisë
- Rastet praktike të cilat do të shqyrtohen gjatë trajnimit do t'i ndihmojnë pjesëmarrësit që të njoftohen në lidhje me formulimin e kërkesave/padive dhe përfaqësimin adekuat në institucionet gjyqësore.

Ky trajnim do të analizoj por nuk do të kufizohet në trajtimin e këtyre çështjeve:

- Aktet kryesore ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut
- Kushtetuta e Kosovës dhe të drejtat e njeriut
- Juridiksioni i GJEDNJ-së
- *Ratione materiae*
- *Rationa personae*
- *Ratione temporis*
- Juridiksioni territorial
- Koncepti i kërkesës qartazi të pabazuar
- Parimi i subsidiaritetit
- Masa e përkohshme
- Raste specifike nga praktika e GJEDNJ në interpretimin e të drejtave specifike nga nenet specifike të KEDNJ-së
- E drejta e privatësisë
- E drejta e pronës
- E drejta e shprehjes së mendimit
- Kufizimi i të drejtave të njeriut
- Inicimi i procedurës, përpilimi i padisë dhe procedura në GJEDNJ
- Obligimi i shteteve karshi GJEDNJ-së
- Zbatimi i vendimeve të GJEDNJ-së nga shtetet anëtare

Kohëzgjatja: Një ditë

Përfituesit: Avokatët dhe avokatët praktikantë

Trajnues:

6.3 Tema: RREGULLAT, JURIDIKSIONI DHE PRAKTIKA E GJYKATËS NDËRKOMBËTARE PENALE

Hyrje:

Gjykata ndërkombëtare penale është krijuar me Statutin e Romës në vitin 1998 ndërsa ka filluar së funksionari në vitin 2003. Qëllimi i kësaj gjykate është ndjekja e personave përgjegjës për krime kundër njerëzimit, gjenocid, krime të luftës dhe agresion.

Objektivat e Trajnimit

- Avancimi i njohurive në lidhje me nocionin e krimeve në juridiksionin e kësaj gjykate
- Njoftimi me organizimi i GJNP-së, rolin e palëve në procedurë dhe funksionimin e kësaj gjykate
- Përpilimi i shkresave në formatin përkatës drejtuar gjykatës
- Pjesëmarrësit do të kuptojnë se si zbatohen vendimet e GJNP-së dhe obligimi i shteteve për të bashëpunuar dhe zbatuar vendimet e kësaj gjykate

Ky trajnim do të analizoj por nuk do të kufizohet në trajtimin e këtyre çështjeve:

- Statuti i Romës për themelimin e GJNP-së
- Parimet e GJND-së
- Juridiksioni i GJNP-së
- Krimet kundër njerëzimit
- Gjenocidi
- Krimet e luftës
- Agresioni
- Raporti i GJNP-së me gjykatat vendore
- Zbatimi i vendimeve të GJNP-së
- Shqyrtimi i rasteve konkrete

Kohëzgjatja: Një ditor

Përfituesit: Avokatët

Trajnues:

6.4 Tema: E DREJTA PËR NJË PROCES TË RREGULLT GJYQËSOR SIPAS KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT (KEDNJ)

Hyrje:

Kushtetuta e Kosovës në nenet 22 dhe 53 të saj parasheh domosdoshmërinë e referimit në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me kufizimet në ushtrimin e lirive dhe të drejtave të njeriut. Në këtë drejtim trajnimi do të fokusohet në sqarimin e procedurës së referimit të rasteve në GJEDNJ ndërsa vëmendje e

veçantë do t'i kushtohet garancioneve të së drejtës për gjykim të drejtë të shoqëruara më përvojën gjyqësore të GJEDNJ.

Objektivat e trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Të identifikojnë procedurat e referimit në GJEDNJ;
- Të njohin mbrojtjen procedurale sipas nenit 6 KEDNJ
- T'i zbatojnë garancionet procedurale në procedurë gjyqësore sipas rasteve praktike të
- GJENDJ.

Ky trajnim do të analizoj por nuk do të kufizohet në trajtimin e këtyre çështjeve:

- Çasja në Gjykatën Evropiane për të drejtat e njeriut (procedura e referimit të rastit);
- Mbrojtjet procedurale sipas nenit 6 të KEDNJ
- E drejta për t'u vënë në dijeni brenda një afati sa më të shkurtër në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme
- E drejta për kohë të përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes
- E drejta për t'u mbrojtur vet ose nëpërmjet ndihmës gjyqësore
- E drejta për t'u ballafaquar me dëshmitarët

Kohëzgjatja: Një ditë

Përfituesit: Avokatët dhe avokatët praktikantë

Trajnues:

6.5 Tema: PARIMET E SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE PUBLIKE DHE INSTITUCIONALE DHE GJYKATA NDËRKOMBËTARE E DREJTËSISË

Hyrje

Komunikimi ndërmjet shteteve kërkon përcaktimin e rregullave për bashkëpunim reciprok të cilat janë përcaktuar në atë që njihet si e drejta ndërkombëtare. E drejta ndërkombëtare është e zhvilluar sot deri në atë masë sa pothuajse përfshinë të gjitha sferat e jetës të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejt në shtetin dhe njeriun. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë është organi kryesor ndërkombëtar për shqyrtimin e kontesteve ndërmjet shteteve në rast të mosmarrëveshjeve specifike.

Objektivat e Trajnimit

- Avancimi i njohurive të pjesëmarrësve në identifikimin burimeve kryesore të së drejtës ndërkombëtare,
- Roli i burimeve të së drejtës ndërkombëtare dhe interpretimi i tyre
- Referimi i rasteve në GJND në rast të ekzistimit të kontestit ndër-shtetëror dhe juridiksioni për dhënien e mendimeve këshillëdhënëse.
- Përpilimi i padisë shtetërore dhe përfaqësimi në këtë gjykatë.
- Njoftimi me rolin e organizatave ndërkombëtare dhe personalitetin e tyre juridik karshi subjekteve tjera të së drejtës ndërkombëtare.

Ky trajnim do të analizoj por nuk do të kufizohet në trajtimin e këtyre çështjeve:

- Burimet e së drejtës ndërkombëtare
- Traktatet
- Normat zakonore
- Parimet e përgjithshme
- Doktrina dhe praktikat gjyqësore
- Burimet tjera të së drejtës ndërkombëtare
- Juridiksioni dhe praktika gjyqësore e GJND-së
- Mendimet këshillëdhënëse
- Rastet kontestimore ndërmjet shteteve
- *Locus standi*
- Përpilimi i padisë shtetërore
- Organizatat ndërkombëtare dhe personaliteti juridik i tyre
- E drejta ndërkombëtare dhe e drejta vendore

Kohëzgjatja: Një ditë

Përfituesit: Avokatët dhe avokatët praktikantë

Trajnues:

7. TRAJNIME NË FUSHËN E TË DREJTËS EVROPIANE

Hyrje:

Ky modul ka për qëllim avancimin e njohurive të avokatëve lidhur me strukturën e Bashkimit Evropian dhe të drejtën e BE-së. Në këtë drejtim do të elaborohen kompetencat dhe fushë veprimtaria e Parlamentit Evropian, Këshillit të Ministrave, Komisionit Evropian, Këshillit Evropian dhe Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.

Objektivat e Trajnimit

- Njoftimi me konceptin e *Acqui* dhe identifikimin e burimeve kryesore të legjislacionit evropian.

- Fitimi i njohfurive me parimet kryesore të legjislacionit evropian, zbatimin e këtij legjislacioni dhe efekti i atij legjislacioni në të drejtën vendore.
- Avancimi i njohurive në lidhje me organizimin e BE-së, procedura vendimmarrëse dhe në veçanti rolin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në interpretimin e legjislacionit evropian.
- Shqyrtimi i rasteve konkrete, përpilimi i padisë përfaqësimi në këtë gjykatë.

Ky trajnim do të analizoj por nuk do të kufizohet në trajtimin e këtyre çështjeve:

- Organizimi institucional i BE-së
- E drejta e BE-së dhe *acqui*
- Burimet e së drejtës së BE-së,
- Parimi i supremacisë të së drejtës së BE-së;
- Parimi i subsidiaritetit
- Efekti i të drejtës evropiane në të drejtën vendore;
- Procedura ordinare legjislative
- Gjykata Evropiane e Drejtësisë dhe referimi preliminar
- Raste nga praktika

8. TRAJNIME NË FUSHËN ADMINISTRATIVE

AKTI ADMINISTRATIV DHE KONFLIKTI ADMINISTRATIV

8.1 Tema: Akti administrativ

Hyrje:

Akti administrativ është manifestim i vullnetit të organeve të administratës shtetërore ose publike me ç'rast vjen deri te lindja, ndryshimi apo shuarja e një marrëdhënie juridike administrative. Çdo veprim, sjellje apo urdhër i një organi të administratës mund të konsiderohet si akt administrativ.

Objektivat e trajnimit

Pjesëmarrësit përmes trajnimit të kësaj teme:

- Do të avancojnë njohuritë e tyre sa i përket nocionit të aktit administrativ;
- Do të kuptojnë formën e akteve administrative si dhe mënyrës së fitimit dhe humbjes së fuqisë së akteve administrative.

Pjesëmarrësit në këtë trajnim do të familjarizohen me:

- Kuptimin e aktit administrativ;
- Karakteristikat e aktit administrativ;
- Llojet e akteve administrative;
- Fuqia e aktit administrativ;
- Ekzekutimi i aktit administrativ.

Kohëzgjatja: Një ditë

Përfituesit: Avokatët

Trajnues:

8.2 Tema: Konflikti administrativ

Hyrje:

Konflikti administrativ është një procedurë administrative gjyqësore për vlerësimin e ligjshmërinë së akteve administrative të nxjerra nga organet administrative të shkallës së dytë apo edhe të shkallës së parë (nëse pala nuk ka pasur të drejtë ankese), si dhe në rast të heshtjes së administratës. Në procedurën e konfliktit administrativ paditësi pretendon se me rastin e nxjerrjes së aktit administrativ nga organi i administratës shtetërore apo publike është shkelur parimi i ligjshmërisë, andaj pala kërkon anulimin e aktit administrativ nga ana e gjykatës kompetente.

Objektivat e trajnimit

Pjesëmarrësit në këtë trajnim:

- Do të avancojnë njohuritë e tyre sa i përket akteve ndaj të cilave mund të iniciohet konflikti administrativ;
- Do të identifikojnë shkaqet për fillimin e kësaj procedure, inicimit të konfliktit administrativ në rast të heshtjes së administratës,
- Do të kuptojnë llojet e konfliktit administrativ, elementeve që duhet të përmbajë padia për inicimin e konfliktit administrativ, autorizimeve të gjykatës për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit administrativ.

Temat që do të trajtohen:

- Shqyrtimi i ligjshmërisë së aktit administrativ-kontrolli gjyqësor i akteve administrative
- Qëllimi i konfliktit administrativ
- Aktet ndaj të cilave mund të filloj konflikti administrativ
- Llojet e konfliktit administrativ
- Inicimi i konfliktit administrativ
- Hartimi i padisë për hapjen e konfliktit administrativ
- Mjetet juridike

Kohëzgjatja: Një ditë

Përfituesit: Avokatët

Trajnues:

9. TRAJNIMET NË FUSHËN KOMERCIALE

Moduli Komercial

9.1. Tema: Kontratat për kredinë, kamatën dhe kamatëvonesën

Hyrje:

Ky trajnim ka për qëllim trajtimin nga këndvështrimi praktik i kontratës për kredinë, formës së kontratës për kredinë, elementet esenciale dhe klauzolat e kontratës për kredinë.

Objektivat e trajnimit

Pas përfundimit të këtij prezantimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Të njihen me përkufizimin e kontratës për kredinë, formën dhe elementet e kësaj kontrate, me klauzolat me të rëndësishme të kontratës për kredinë;
- Njiheni me përkufizimin e kamatës, me formën e llogaritjes së kamatës
- Të krahasojnë ndryshimet e dispozitave ligjore në mes të LMD-së në fuqi dhe LMD-së së vitit 1978
- Të njihen me klauzolat me të rëndësishme në lidhje me kamatëvonesën dhe shpërblimin e dëmit në rast të vonesës në kryerjen e obligimeve;
- Të kuptojnë mënyrën e përlllogaritjes së kamatës kontraktore dhe mënyrën e përlllogaritjes së kamatëvonesës, sipas praktikave të bankave në Kosovë - Rregullave të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, dhe dispozitave të Ligjit të ri të marrëdhënieve të detyrimeve.

Me theks të veçantë do të diskutohet:

- Rregullimi i kontratës për kredinë me legjislacionin në fuqi në Kosovë
- Forma e kontratës për kredinë
- Elementet esenciale të kontratës për kredinë
- Kamata, ndalimi i kamatës në kamatë
- Supozimi i kontratës me fajde
- Mënyra e llogaritjes së kamatës dhe kamatëvonesës
- Riprogramimi i kredisë
- Raste nga praktika

Kohëzgjatja: Një ditë

Përfituesit: Avokatët

Trajnues:

9.2 Tema: Shoqëritë Tregtare

Hyrje:

Gjatë këtij trajnimi do të diskutohet për konceptet kryesore të Ligjit për Shoqëritë

Tregtare, i cili rregullon veprimtaritë afariste në Kosovë. Qëllimi themelor i këtij trajnimi është ofrimi i njohurive më të thella lidhur me themelimin, operimin, dhe shpërbërjen në mënyrë të rregullt dhe efikase të shoqërive tregtare, si dhe për çështjet që i përkasin këtyre shoqërive. Një vëmendje e posaçme do t'i përkushtohet llojeve të ndryshme të shoqërive tregtare, arsyeve pse të zgjedhet njëra strukturë mbi tjetrën, si dhe çështjet të tjera të rëndësishme të cilat profesionistët e lëmit juridik do t'i hasin në praktikën e tyre.

Objektivat e Trajnimit

Pas përfundimit të këtij prezantimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- T'i analizojnë praktikën e kaluara të ushtrimit të afarizmit në Kosovë dhe të shpjegojnë arsyet për kalimin në struktura formale afariste të llojllojshme
- Të përshkruajnë rolin e ri të kufizuar të Regjistrimit të Bizneseve dhe funksionet e tij
- Të regjistrojnë lloje të ndryshme të shoqërive afariste në Kosovë
- T'i identifikojnë karakteristikat kryesore të një ndërmarrjeje Individuale dhe arsyet pse kjo strukturë shfrytëzohet nga 90% e bizneseve Kosovare
- Të kuptojnë natyrën e Shoqërive Kolektive
- Të bëjnë dallimin mes Shoqërive Komandite dhe Shoqërive Kolektive
- Të përcaktojnë se kur duhet të shfrytëzohet Shoqëria Aksionare në afarizëm
- T'i krahasojnë përparësitë dhe mangësitë e secilës strukturë afariste
- Të tregojnë se si do ta përkrahë Ligji për Shoqëritë Tregtare ekonominë e tregut.

Rëndësi do të ÷u kushtohet edhe kategorive si në vijim:

- Roli i gjykatave në zgjidhjen e kontesteve të aksionarëve
- Regjistrimi i shoqërive tregtare dhe ndryshimet themelore korporative
- Ndërmarrjet individuale
- Shoqëritë kolektive
- Shoqëritë komandite
- Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar
- Shoqëritë aksionare
- Raste nga praktika

Kohëzgjatja: Një ditë

Përfituesit: Avokatët

Trajnues:

9.3 Tema: Përgjegjësia parakontraktuese, formimi dhe interpretimi i kontratave

Hyrje:

Në këtë trajnim do të trajtohen çështjet ligjore që ndërlidhen me kontratat, e në veçanti theksi vihet mbi detyrimet dhe përgjegjësinë parakontraktuese, si dhe problemet aktuale në fushën e zbatimit të këtyre kërkesave ligjore në lidhje me përgjegjësinë parakontraktuese në praktikë, si dhe një përshkrim i përgjithshëm i Ligjit për detyrimet për këtë institut juridik.

Objektivat e Trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Të kuptojnë kornizën e përgjithshme ligjore për detyrimet dhe përgjegjësinë parakontraktuese sipas kërkesave të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve.
- Të kuptojnë praktikën që është e lidhur me zbatimin e kërkesave ligjore për përgjegjësinë parakontraktuese
- Të analizojnë kuptimet dhe kërkesat e dispozitave të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve në lidhje me përgjegjësinë parakontraktuese
- Të përshkruajnë kornizën e përgjithshme ligjore për Ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve lidhur me kushtet e përgjithshme për lidhjen e kontratave
- Të kuptojnë aspektet e autonomisë së vullnetit të palëve, si dhe se si interpretohet vullneti i palëve, nëse vullneti i deklaruar nuk përputhet me vullnetin e brendshëm të palëve
- Të kuptojnë rregullat e veçanta dhe teknikat e interpretimit të kontratave.

Gjatë këtij trajnimit do të diskutohet:

- Baza ligjore për përgjegjësinë parakontraktuese
- Detyrimet para-kontraktuale - detyrimet e informimit të palës
- Lidhja e kontratave
- Interpretimi jashtëgjyqësor dhe gjyqësor i kontratave
- Interpretimi i dispozitave të qarta dhe jo-kontestuese, dhe interpretimi i dispozitave të kontestueshme dhe jo të qarta të kontratave
- Teknika e interpretimit
- Raste nga praktika

Kohëzgjatja e trajnimit: Një ditë

Përfituesit: Avokatët

Trajnues:

9.4 Tema: Qeverisja korporative

Hyrje:

Ky trajnim ka për qëllim shpjegimin e çështjeve dhe koncepteve kryesore ligjore të qeverisjes korporative/rregullimit të brendshëm të shoqërive tregtare. Prezantimi është posaçërisht i dobishëm për avokatët të cilët punojnë me shoqëri tregtare në mënyrë të rregullt si dhe që u ndihmojnë klientëve dhe palëve për qeverisjen e shoqërive të tyre tregtare në përputhje me rregullat dhe rregulloret përkatëse, qofshin ato të brendshme ose të jashtme. Prezantimi përqendrohet më shumë në profesionistët ligjor të cilët kanë klientë që dëshirojnë të mësojnë të qeverisin në mënyrë të rregullt dhe të ligjshme subjektin të cilin e udhëheqin dhe drejtojnë në bazë ditore, pra me klientë dhe/ose raste nga komuniteti i biznesit.

Objektivat e Trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Që të kuptojnë qeverisjen korporative dhe çështjet ligjore që ndërlidhen me të
- Të përshkruajnë çështjet kryesore të adresuara nga marrëveshjet e pronësisë dhe rregulloret
- Të përcaktojnë kushtet e konfliktit të interesave dhe transparencës
- Të përcaktojnë se si auditimi ndikon në qeverisjen e shoqërive tregtare
- Të ofrojnë informata për çështjet e përputhshmërisë, respektivisht përputhshmërisë rregullatore
- Të përshkruajnë çështjet ligjore që ndikojnë në qeverisjen korporative të Ndërmarrjeve Publike

Ndër të tjera do të diskutohet edhe për:

- Qeverisja korporative në Shtetet e Bashkuara dhe Mbretërinë e Bashkuar
- Qeverisja korporative në Bashkimin Evropian
- Parimet e OBZHE-së për qeverisje korporative korporatave
- Marrëveshja e ortakërisë dhe rregulloret/ Etika e biznesit në përgjithësi
- Politika për parandalimin e konfliktit të interesave
- Raste nga praktika

Kohëzgjatja e trajnimit: Një ditë

Përfituesit: Avokatët

Trajnues:

9.5 Tema: Konventa e Kombeve të Bashkuara për shitjen ndërkombëtare të mallrave

Hyrje:

Ky trajnim iu ofrohet avokatëve me qëllim që të diskutohet për Konventën e Kombeve të Bashkuara për shitjen ndërkombëtare të mallrave, aplikimin a kësaj Konvente në Kosovë.

Objektivat e Trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- T'i kuptojnë përparësitë dhe të metat e KShNM-së;
- Të kuptojnë strukturën e KShNM-së.
- Të kuptojnë zbatueshmërinë e KShNM-së në kontratat që lidhen me një shtet kontraktues dhe një shtet jo-kontraktues
- T'i interpretojnë situatat/kontratat sipas zbatueshmërisë të KShNM-së
- Të analizojnë një rast dhe të vendosni se cili mjet juridik zbatohet.

Në veçanti do të diskutohet:

- Fushëveprimi i aplikimit të Konventës;
- Rregullat për fushëveprimin e aplikimit
- Kontratat për shitjen e mallrave dhe karakteri ndërkombëtar
- Aplikimi i KSHNM nga tribunalet e arbitrazhit
- Formimi i kontratës
- Modeli tradicional i ofertës dhe pranimit
- Modifikimi i kontratës
- Obligimet/detyrimet e palëve
- Të drejtat e palës së tretë
- Mjetet juridike të blerësit
- Raste nga praktika

Kohëzgjatja e trajnimit: Një ditë

Përfituesit: Avokatët

Trajnues:

9.6 Tema: Arbitrazhi

Hyrje:

Ky trajnim iu ofrohet avokatëve lidhur me njërin nga metodat më të shpeshta për zgjidhjen alternative të kontesteve sic është arbitrazhi. Në këtë trajnim do të trajtohet rregullimi ligjor i kësaj fushe në Kosovë.

Objektivat e Trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Të shpjegojnë dhe zbatojnë konceptet kryesore dhe parimet e Arbitrazhit;
- Të interpretojnë dhe shqyrtojnë qëllimin e fushëveprimit të Ligjit të Kosovës për Arbitrazhin;
- Të përcaktojnë kufijtë e juridiksionit të gjykatës, ku palët zgjedhin formën e arbitrazhit për zgjidhjen e kontekstit;
- Të hartojnë marrëveshjen e arbitrazhit/ose vendimin;
- Të krahasojnë dhe bëjnë dallimin në mes të marrëveshjes së vlefshme dhe të pavlefshme/ose vendimit;
- Të kuptojnë rregullat mbi njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit

Temat që do të diskutohen:

- Ligji i Kosovës për arbitrazhin
- Marrëveshja e arbitrazhit
- Tribunalet e arbitrazhit në Kosovë
- Procedura e arbitrazhit
- Forma dhe efekti i vendimit
- Njohja dhe përmbartimi i vendimeve të arbitrazhit
- Zbatimi i Konventës së Nju Jorkut dhe kushtet e saj mbi njohjen dhe përmbartimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit
- Raste nga praktika

Kohëzgjatja e trajnimit: Një ditë

Përfunduesit: Avokatët

Trajnues:

9.7 Tema: Ligji për ndërmjetësimin

Hyrje:

Ky trajnim një ditor është dizajnuar për të siguruar kornizën e koncepteve kryesore të Ligjit për Ndërmjetësimin si një nga instrumentet kyçe ligjore që rregullon aktivitetet e ndërmjetësimin në Kosovë.

Objektivi parësor i këtij trajnimi është që të ofrojë kuptimin e rrënjësor të parimeve dhe të rregullave më të rëndësishme të cilat qeverisin aktivitetet e ndërmjetësimin në Kosovë, të cilat rrjedhin nga legjislacioni kombëtar.

Objektivat e Trajnimit

Pas përfundimit të këtij prezantimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Të kuptojnë parimet dhe procedurën e ndërmjetësimin në Kosovë
- Të kuptojnë protokollet e referimit të rasteve nga gjykatat dhe prokuroritë në qendrat e ndërmjetësimin në Kosovë

Vëmendje e veçantë do i kushtohet:

- Marrëdhënies në mes të ndërmjetësimin dhe mekanizmave tjerë për zgjidhje alternative të kontestit
- Rregullave kombëtare dhe ndërkombëtare për ndërmjetësim
- Pasojave ligjore të çfarëdo detyrimi për ndërmjetësim
- Marrëveshjes së ndërmjetësuar e ujdisë dhe pasojat ligjore të saj
- Rolit dhe përgjegjësi të ndërmjetësuesve si dhe kornizës institucionale dhe rregullative që qeverisë ndërmjetësimin
- Protokollit të referimit të rasteve nga gjykatat dhe prokuroritë në qendrat e ndërmjetësimin etj
- Raste nga praktika

Kohëzgjatja e trajnimit: Një ditor

Përfituesit: Avokatët

Trajnues:

9.8 Tema: Markat tregtare

Hyrje:

Ky kurs është i përpiluar për grupe profesionistësh të lëmit juridik dhe grupe të tjera profesionistësh që punojnë me Markat Tregtare. Kursi është posaçërisht i dobishëm për gjykatës dhe avokatë të cilët merren me raste të markave tregtare dhe të cilët u ndihmojnë klientëve dhe palëve në procesin e fitimit, realizimit, dhe mbrojtjes së të drejtave të markave tregtare.

Objektivat e Trajnimit

Pas përfundimit të këtij prezantimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Të shpjegojnë nevojën për markat tregtare në ekonominë e tregut
- Të krahasojnë Ligjin për markat tregtare të Kosovës me instrumentet ndërkombëtare
- Të krahasojnë nivelet e ndryshme të fuqishmërisë së markës tregtare
- Të shpjegojnë rolin e doganave në luftimin e falsifikimit dhe në realizimin e të drejtave nga markat tregtare.

Në këtë trajnim do të trajtohen këto tema:

- Pronësia Intelektuale dhe Markat Tregtare
- Ndikimi i Markave Tregtare në Zhvillimin e Ekonomisë
- Instrumentet Kryesore Ndërkombëtare dhe ato të Acquis Communautaire të BE-së relevante për Markat Tregtare
- Ligji për Markat Tregtare i Kosovës dhe Përputhshmëria e tij me Instrumentet Ndërkombëtare dhe të BE-së për MT-të
- Llojet e markave tregtare
- Parakushtet për mbrojtjen e markave tregtare
- Raste nga praktika

Kohëzgjatja e trajnimit: Në ditor

Përfituesit: Avokatët

Trajnues:

9.9 Tema: Falimentimi

Hyrje:

Ky trajnim një ditor është dizajnuar me qëllim që të trajtohet procedura e falimentimit dhe të iu ofrohet një pasqyrë më e qartë juristëve të cilët trajtojnë rastet e falimentimit në Kosovë.

Objektivat e Trajnimit

Pas përfundimit të këtij prezantimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Të kuptojnë në përgjithësi se çka do të thotë falimentimi, likuidimi dhe riorganizimi;
- Të analizojnë se si trajtohet falimentimi, likuidimi dhe riorganizimi në shtetet tjera.
- Të informohen për llojeve të shoqërive tregtare të mbuluara nga ky ligj; dhe
- Të parashtrojnë kërkesën për falimentim;

- Të kuptojnë pasojat e parashtrimit të kërkesës së palejuar.
- Sqaroni atë që quhet pasuri e falimentimit;
- Të informohen se çka ndodhë me veprimet ose faturat e lëna pezull;
- Shisen pasurinë e falimentimit;
- Shpërndajnë të hyrat nga shitjet në bazë të prioriteteve të kërkesave;
- Të hartojnë raportin përfundimtar;
- Të mbyllin rastin
- Të përshkruajnë përgjegjësitë penale për veprime të ndryshme;
- T'i identifikojnë të metat kryesore të cilat e bëjnë këtë Ligj të pazbatueshëm.

Me theks të veçantë do të trajtohen temat si në vijim:

- Ligji për falimentimin, likuidimin dhe riorganizimin e personave juridik
- Parashtrimi i kërkesës për falimentim
- Pasuria e falimentimit
- Paraqitja e kërkesave
- Riorganizimi
- Likuidimi dhe mbyllja e rastit
- Përgjegjësia civile dhe penale
- Raste nga praktika

Me miratimin e ligjit të ri të falimentimit në vitin 2017, struktura e trajnimit do të ndryshoj për të përfshirë edhe falimentimin e bizneseve individuale, ortakërive të përgjithshme dhe ortakërive të kufizuara. Për më tepër, ligji i ri i falimentimit parashihet të përfshijë dispozita specifike mbi riorganizimin e të gjitha formave të shoqërive tregtare, kufizimin e çasjes së kreditorëve ndaj asetëve të debitorëve individual që nuk janë të përfshira në afarizëm, moratoriumin ndaj kreditorëve dhe dispozitat mbi falimentimin ndërkombëtar.

Kohëzgjatja e trajnimit: Një ditë

Përfituesit: Avokatët

Trajnues:

9.10 Tema: Procedura Përmbare

Hyrje:

Ky trajnim një ditë do të përmbledh çështjet kyçe rreth procedurës përmbare me një theks të veçantë në sistemin e ri të përmbaremit në Kosovë i cili ka filluar të

funksionoj që nga 5 maj 2014. Në këtë trajnim, trajtohet rregullimi ligjor i kësaj fushe në Kosovë si dhe aktet nënligjore për funksionalizimin e përmbarimit privat.

Objektivat e Trajnimit

Pas përfundimit të këtij prezantimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Të kuptojnë sistemin e ri të përmbarimit në Kosovë
- Të kuptojnë se kur është i përshtatshëm një dokument përmbarimor
- Të kuptojnë se si të urdhërohet sekuestrimi në xhirollogaritë bankare te debitorit dhe transferimi i shumave në xhirollogaritë bankare te kreditorit
- Obligimet e bankave gjatë procedurës përmbarimore
- Të informohen për përmbarimin në të ardhura personale
- Të kuptojnë procesin për përmbarimin e mjeteve monetare të autoriteteve publike përmes thesarit
- Të kuptojnë si organizohen dhe si zhvillen ankandet
- Si të veprohet në situatat e mospagimit për shkak të varfërisë apo transferimeve mashtruese

Disa nga çështjet më kyçe që do të diskutohen janë::

- Procedura Përmbarimore
- Parimet e veçanta të procedurës përmbarimore
- Roli i Kreditorit, Debitorit, Përmbaruesit Privat dhe Gjykatës
- Modalitetet e Përmbarimit Civil
- Shqyrtimi i lejimit përmbarimor dhe lejimi i përmbarimit
- Dokumenti përmbarimor dhe dokumenti autentik
- Përmbarimi në llogaritë bankare
- Veprimet përmbarimore në sendet e luajtshme

Kohëzgjatja e trajnimit: Një ditë

Përfituesit: Avokatët

Trajnues:

9.11 Tema: Kontrata për licencën, lizingun, kontrollin e mallrave dhe magazinimin

Hyrje:

Në këtë modul një ditë do të diskutohen çështjet ligjore që ndërlidhen me kontratën për licencën, lizingun, kontrollimin e mallrave dhe magazinimin në Kosovë.

Do të diskutohen këto tema:

- Rregullat ligjore dhe ndërkombëtare të kontratës për licencën, lizingun, kontrollimin e mallrave dhe magazinimin si dhe problemet aktuale në fushën e zbatimit të këtyre kontratave në qarkullimin e mallrave dhe në dhënien e shërbimeve në territorin e Republikës së Kosovës;
- Përshkrim i përgjithshëm i Ligjit për detyrimet dhe ligjeve tjera përkatëse.

Objektivat e Trajnimit

Pas përfundimit të këtij prezantimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Të kuptojnë kornizën e përgjithshme ligjore për kontratën e licencës, lizingut, kontrollimit të mallrave dhe magazinimit në Ligjin e detyrimeve të Kosovës dhe aktet tjera ligjore në fuqi në Kosovë.
- Të analizojnë praktikën që është e lidhur me zbatimin kontratës për licencën, lizingun, kontrollimin e mallrave dhe magazinimin që nga viti 1999 dhe problemet e ndërlidhura me to.
- Të shpjegojnë disa nga dispozitat e Ligjit për detyrimet dhe Ligjit të licencës të Kosovës

Kohëzgjatja e trajnimit: Një ditë

Përfituesit: Avokatët

Trajnues:

10. TRAJNIME NGA FUSHA E ETIKËS PROFESIONALE

10.1.Tema: Etika profesionale e Avokatëve, Sistemi disiplinor dhe Tarifa e OAK-së

Hyrje:

Ky modul është i nevojshëm me qëllim që avokatët të avancojnë njohuritë e tyre për kërkesat që përmbajnë dispozitat ligjore dhe rregullat e “Kodit të Etikës profesionale të avokatëve”, “Sistemi Disiplinor në OAK” dhe zbatimin e drejtë të tarifave të OAK-së, mënyra e përpilimit të listës së shpenzimeve dhe shpërblimit për Avokatë.

Rregullat e Etikës paraqesin ndihmesë dhe mbështetje për avokatët në kryerjen e detyrave të tyre. Nga avokatët pritet të zbatohen standarde të larta në kuptim të korrektësisë, sjelljes së dinjitetshme dhe humanitetit.

Objektivat e Trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Të kuptojnë përmbajtjen e Kodit të Etikës profesionale, rregullore të procedurës Disiplinore;
- Të zbatojnë në praktikë ndryshimet e Kodit të Etikës Profesionale dhe rregullore për procedurën Disiplinore;
- Të zbatojnë drejtë tarifën e OAK-së
- Të kuptojnë drejtë mënyrën e përpilimit të listës së shpenzimeve
- Të kuptojnë rëndësinë e Sistemit Disiplinor në OAK, bazuar në Rregulloren për procedurën disiplinore;
- Të identifikojnë ndryshimet në kodin e etikës, rregulloren për proc. Disiplinore, Tarifën e OAK-së.

Temat që do të trajtohen në këtë modul do të jenë:

- Puna e avokatëve,
- Tarifa e Avokatëve
- Raportet e Avokatëve me institucionet;
- Raportet e Avokatëve me Klientë;
- Raportet e Avokatëve me Avokatë;
- Pavarësia,
- Besimi në publik,
- Parimet e përgjithshme të etikës profesionale,
- Përgjegjshmëria,
- Procedurat dhe sanksionet për shkelje të etikës,
- Konflikti i interesave;
- Raste nga praktika.

10.2 Kurse speciale

10.2.1 Tema: Themelimi dhe menaxhimi i zyrave të përbashkëta të Avokatëve

Hyrje:

Ky trajnim është i nevojshëm më qëllim që avokatët të njohin më për së afërmi me menaxhimin e një zyreje të përbashkët.

Objektivat e Trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Të kuptojnë rëndësinë dhe mënyrën e themelimit të zyrave të përbashkëta;
- Të kuptojnë mënyrën e menaxhimit të zyrave të përbashkëta;

- Të përpilojnë planin e biznesit për themelimin e zyrës;
- Të identifikojnë fushat në të cilat do të japin shërbime ligjore;

Në kuadër të këtij trajnimi do të trajtohet prezantimi i një Firme të imagjinuar Avokatie e cila do të përfshijë:

- Marrëveshjen e partneritetit për themelimin e një zyreje avokatie;
- Përgatitjen e planit të biznesit;
- Zgjedhjen e fushave primare të shërbimeve ligjore, tregun dhe konkurrencën si dhe fitimet e pritshme dhe shpenzimet;
- Raste nga Praktika;

Kohëzgjatja: Disa ditore

Përfunduesit: Avokatët

Trajnues:

10.2.2 Tema: Zhvillimi i Shkathtësive të Përfaqësimit gjatë Gjykimit

Hyrje:

Ky trajnim ka të bëjë me ngritjen e shkathtësive praktike lidhur me prezantimin dhe administrimin e provave, metodat e marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe prezantimin e rasteve në gjykatë. Bazuar në ndryshimet e fundit të kodit të procedurës penale lidhur me mënyrën e marrjes në pyetje, prezantimin e provave dhe udhëheqjen e shqyrtimit gjyqësor është e nevojshme që avokatët të ngrisin shkathtësitë praktike të përfaqësimit të rasteve gjatë gjykimit. Në mënyrë specifike duhet të bëhet ngritja e shkathtësive lidhur me prezantimin e fjalës hyrëse, marrjen e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në pyetje si dhe fjalën përfundimtare.

Objektivat e Trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Zbatojnë drejtë dispozitat materiale e procedurale lidhur me fjalën hyrëse, marrjen në pyetje të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë si dhe fjalën përfundimtare;
- Bëjnë dallimin në mes të marrjes në pyetje të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë;
- Bëjnë dallimin në mes të fjalës hyrëse dhe përfundimtare
- T'i identifikojnë të metat kryesore të cilat e bëjnë këtë mënyrën e përfaqësimit;
- Të informohen për strategjinë efikase të mbrojtjes.

Në kuadër të këtij trajnimi do të trajtohen çështjet si;

- fjala hyrëse,
- marrja e drejtpërdrejt në pyetje,
- marrja e tërthortë në pyetje,
- vënia në dyshim,

- riekzaminimi dhe rehabilitimi dhe
- argumentimi përfundimtar.

Kohëzgjatja e trajnimit: Tre ditorë

Përfituesit: Avokatët

Trajnues:

11. Publikimet e OAK-së

Gjatë vitit 2017, Qendra Trajnuese e OAK ka planifikuar që aktivitetin e saj ta plasoj përmes buletineve të OAK-së.

Në këto publikime do të pasqyrohen aktivitetet trajnues i QT të OAK-së dhe atë përmes:

- Revista informative Avokati Kosovar;
- Publikimin e materialit trajnues;
- Web faqja.

Nëpërmjet kësaj avokatët do të informohen si dhe do të mund të aplikojnë për pjesëmarrje në trajnime të ndryshme varësisht nga vlerësimi i tyre lidhur me nevojën për trajnim.

12. Përfundim

Programi i Trajnimeve të Qendrës Trajnuese të OAK-së, për vitin 2017 është një program profesional me qëllim të përmbushjes së nevojave reale të avokatëve.

Përveç trajnimeve dhe moduleve të përcaktuara me këtë program, OAK, sipas nevojës do të mund të organizoj edhe aktivitete tjera trajnuese apo profesionale, për profesionistët tjerë të përcaktuar nga OAK, apo nëse aktivitetet propozohen dhe mbështeten nga donatorët të cilët bashkëpunojnë me OAK-në. Megjithatë në përcjellje të reformës në sistemin gjyqësor me të cilën është e lidhur ngushtë edhe avokatia, mund të rishikohet zbatimi i këtij programi në aspektin e përmbajtjes

dhe mundësive financiare.

Ky program prezantohet për miratim duke qenë të bindur se është i hartuar në pajtim me parametrat ligjor, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare si dhe në pajtim me nevojat e përfituesve të tij.

Zbatimi i këtij programi është prioriteti kryesor i QTA-së, veçanërisht tani kur sistemi i drejtësisë së Kosovës është duke kaluar në një reformë rrënjësore në të cilën avokatia ka një rol të rëndësishëm.

Në këtë drejtim roli i OAK-së është sigurimi dhe garantimi i një avokatie profesionale për të shërbyer në sistemin e drejtësisë të Kosovës, sistem i cili iu shërben dhe gëzon besimin e të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Programi i Trajnimeve të QT të OAK-së, për vitin 2017, është miratuar nga Këshilli Drejtues i OAK-së, më: _____.